


KOMUNA E GJAKOVËS

Përmbledhje e përgjithshme

Performanca e përgjithshme e komunës në 19 fusha të matjes për vitin 2019 ka dalë 64.56%. Vitin e kaluar performanca e Komunës së Gjakovës në sistemin me 14 fusha dhe 77 tregues ishte 65.2%. Pra, këtë vit ka një rritje në performancë edhe pse këtë vit SMPK ka shtuar disa tregues më të avancuar me qëllim të avancimit të performancës komunale.

Fusha me performancën më të lartë është fusha e Transparenca Komunale me 88.8%, Uji i Pijshëm me 87.5%, Menaxhim të Fatkeqësive me 100% si dhe Menaxhimi i Mbeturinave me 88.0%. Ndërsa, **fushat me performancën më të ulët** është fusha për Parkingjet Publike në vlerën prej 26.9%, fusha për Infrastrukturë Rrugore me 37.8%, si dhe fusha për Rrjetin e Kanalizimit me 43.7%. Performanca në fushën e infrastrukturës rrugore kryesisht ka dalë më e ulët në gjitha komunat për shkak të treguesëve të ri të shtuar.

Gjatë procesit të verifikimit është vërejtur që komuna ka patur mungesë të dokumentimit të të dhënave apo dokumentim jo adekuat në 10 nga 119 treguesit ndërsa si rezultat i procesit të verifikimit 7 tregues kanë pësuar një vlerësim më të ulët se që ishin raportuar nga komuna ndërsa 1 tregues ka pësuar vlerësim më të lartë, pra treguesi 5.1.1 për hapësirat për ambiente sportive.



PERFORMANCA SIPAS FUSHAVE

Fusha 1: Shërbimet Administrative

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 85.5%. Këtë vit janë shtuar disa të dhëna të reja për ofrimin e shërbimeve elektronike që e kanë ndikuar këtë performancë të komunës, megjithatë Komuna e Gjakovës qëndron kryesisht më përpara se shumica e komunave tjera në ofrimin e mundësisë për aplikim të certifikatave online.

Gjatë periudhës së vitit 2019, Komuna ka pranuar gjithsej 48,116 kërkesa në procedurë administrative të parashtruara nga qytetarët, prej të cilave 46,392 janë shqyrtuar apo 96.4%, kurse 3.6% e kërkesave nuk janë shqyrtuar, apo kanë mbetur në proces të shqyrtimit. Nga kërkesat e parashtruara për të cilat ka pasur proces të shqyrtimit administrativ, 100% prej tyre kanë përfunduar brenda afatit ligjor.

Komuna ka raportuar për kërkesat e parashtruara në formë elektronike, përfshirë: shërbimet për pajisje me pesë certifikata të gjendjes civile si dhe faturën për tatimin në pronë. Megjithatë, nuk mundësohet aplikimi apo lëshimi online i faturave për certifikatë në pronë (fletën poseduese), faturën për menaxhimin e mbeturinave apo kërkesën për lejën e ndërtimit.

Fusha 2: Transparenca komunale

Performanca e përgjithshme në fushën e transparencës është 88.7%, pra një nivel mjaft i kënaqshëm. Në nivel të treguesve, komuna ka pasur performancë të plotë të publikimit të njoftimeve dhe të gjitha nga 11 seancat e kuvendit janë transmetuar online përmes ueb-faqes së Kuvendit. Kriteret për faqen zyrtare elektronike janë përmbushur plotësisht. Nga 76 aktet komunale të miratuara në kuvendin komunal janë gjetur të publikuar në ueb-faqe të gjitha prej tyre. Po ashtu, nga 211 akte të deklaruar si të miratuara nga Kryetari në ueb-faqe gjenden 211 të publikuara.

Dokumentet për planifikim dhe shpenzim buxhetor janë të publikuara të gjitha por buxheti nuk është i publikuar në ueb-faqe ashtu si buxheti i miratuar në kuvend komunal por shtojca nga Buxheti i Shtetit. Tek dokumentet e prokurimit publik, plani i prokurimit është publikuar por jo edhe raporti i realizimit të planit të prokurimit për 2019. Kontrata të nënshkruara janë 124 dhe ato janë të publikuara në ueb-faqen e komunës të publikuara.

Fusha 3: Përgjegjshmëria komunale

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 61.1%. Kjo është një fushë kryesisht e re e SMPK-së me 22 tregues.

Njoftimet për dy takimet publike janë publikuar në ueb-faqe por njoftimi për takimin e parë nuk është publikuar 14 ditë përpara siç kërkohet me rregullore por vetëm nëntë ditë përpara. Janë organizuar pesë diskutime publike për pesë nga aktet e Kuvendit Komunal me interes të përgjithshëm. Ndërsa, janë mbajtur 12 dëgjime publike për buxhetin e vitit të ardhshëm dhe një dëgjim për Kornizën Afatmesme të Buxhetit. Këto dëgjime përmbushin 100% standardin e vënë për këtë vlerësim, apo së paku një dëgjim për 10,000 qytetarë. Po ashtu, është publikuar një procesverbal me kërkesa të qytetarëve nga dëgjimet buxhetore.

Numri i pjesëmarrësve në konsultimet publike ishte 2.587 apo 91.2% e standardit të vënë i cili krahasohet me popullatën e komunës. Megjithatë, zbatimi i standardeve minimale të konsultimit publik mbetet ende për tu përmbushur plotësisht për shkakun që komuna ka publikuar vetëm 13 raportet e 20 proceseve të konsultimeve publike gjatë vitit. Ndërsa, këshillat lokal kanë qenë të themeluar për 30 vendbanime nga 91 sa ka komuna. Ndërsa deklarohet se 14 nga ato të themeluara kanë mbajtur së paku 6 takime në vit, ashtu sipas udhëzimit administrativ i cili rregullon këta trupa.

Të dhënat tregojnë që kryetari ishte prezent në të gjitha nga 11 mbledhjet e mbajtura të kuvendit komunal.

Në kuadër të procedurave të aprovimit të buxhetit komunal komuna ka përmbushur obligimin ligjor për dorëzimin e buxhetit të komunës nga kryetari tek kuvendi komunal para datës 1 shtator dhe se kuvendi të njëjtin e ka aprovuar para datës 30 shtator. Komuna ka shqyrtuar në Kuvend katër raporte buxhetore tre-mujore dhe ka shqyrtuar në Kuvend raportin e auditorit të jashtëm për komunën. Megjithatë, Komuna nuk ka shqyrtuar në Kuvend raportin e performancës të vitit paraprak apo raportin e auditorit të brendshëm me planin e veprimit apo raportin e integritetit. Për më tepër, komuna ka arritur të zbatojë vetëm 26.3% të rekomandimeve të Auditorit të jashtëm.

Skema për shpërndarje të vlerësimeve të shërbyesve civil është zbatuar në masën 100% pasi është ndjekur për 328 nga 328 zyrtarët publik.

Komuna nuk ka patur zyrtarë me aktakuza andaj edhe nuk ka patur të suspenduar për këtë arsye. Ndërsa për kontrata për shërbime të veçanta ka dëshmi se janë në pajtueshmëri me ligjin vetëm 22 nga 64 kontrata të tilla për punësim të përkohshëm.

Realizimi i planit të prokurimit është deklaruar të jetë në masën 72.9% ku janë shpenzuar afër 14,3 milion euro nga mbi 19,4 milion euro të planifikuar. Niveli i pagesave të procesuara nga komuna brenda afatit ligjor prej 30 ditëve ka qenë 82.5%.

Fusha 4: Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare

Performanca e përgjithshme e kësaj komune në këtë fushë është 45.6%.

Komuna e Gjakovës ka dy të punësuar me aftësi të veçanta nga gjithsej 2,428 punonjës të administratës komunale, duke mos përmbushur kështu kriterin minimal të përcaktuar me ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Në bazë të dhënave të ASK-së, Komuna e Gjakovës ka gjithsej 94,556 banorë prej të cilëve 87,672 Shqiptar, dhe 6,884 banorë nga komunitetet tjera. Përfshirja e të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë ka qenë në vlerën 55.4% apo gjithsej 98 të punësuar nga komunitet jo-shumicë nga të cilët 16 gra.

Komuna ka siguruar banim social për 12 familje në nevojë nga 45 sa kanë qenë të regjistruara për banim social, ndërsa deklarohet se 4 familje e kanë lëshuar banimin social këtë vit. Fëmijë me nevojë që janë strehuar në familje kanë qenë katër aq edhe sa janë paraqitur.

Fusha 5: Kulturë, Rini dhe Sport

Performanca në këtë fushë Kulturë, Rini dhe Sport ka dal tejet e ulët për vitin 2019, 62.4%. Komuna ka gjithsej në menaxhim 41,798m² hapësira sportive, por deklarohet se nuk ka hapësirë sportive të shtuar në vitin raportues. Komuna ka organizuar gjithsej 235 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive duke përmbushur 100% të standardit të kërkuar në raport me numrin e popullsisë (1 aktivitet për 1,000 banorë në vit). Performanca për pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive

është realizuar në masën 61.3% apo 8,570 pjesëmarrës në aktivitete kulturore gjatë vitit, 6,500 pjesëmarrës në aktivitete rinore dhe 43,000 pjesëmarrës në aktivitete sportive.

Fusha 6: Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 100%. Komuna ka deklaruar shtatë veprime të planifikuara me planin komunal për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe se janë realizuar të gjitha nga ato veprime. Po ashtu, komuna ka raportuar se ekipet e saj kanë intervenuar në 1,245 fatkeqësi aq edhe sa kishin ndodh në komunë gjatë vitit 2019.

Fusha 7: Planifikimi Hapësinorë

Komuna e Gjakovës ka një territor prej 58,700 ha, dhe në vitin 2019, 2,736.37 ha prej tyre kanë qenë të mbuluara me plane rregulluese të hollësishme, apo 4.7% e totalit.

Përqindja e arritur në këtë fushë është vetëm 46.3%. Komuna ka pasur gjithsej 151 kërkesa për leje ndërtimore ndërsa janë deklaruar se janë shqyrtuar 120 prej tyre. Komuna ka deklaruar se ka inspektuar 100% të 38 objekteve të reja të ndërtuara gjatë vitit të raportimit. Ndërsa 84.2% objekte të reja në vitin raportues janë deklaruar me leje të ndërtimit.

Fusha 8: Hapësirat publike

67.2% është e arritura e Komunës në këtë fushë. Komuna ka raportuar se ka gjithsej 14,7ha me hapësira të gjelbra publike nga 58,600ha sipërfaqe e komunës, pra vetëm 1.5% e sipërfaqes përbën hapësirë publike që nënkupton parqet, kopshtet publike dhe hapësirat e gjelbra që janë në menaxhim të komunës dhe në shërbim të gjerë të qytetarëve, si dhe kopshtet dhe hapësirat e gjelbra të institucioneve publike të veçanta, si: shkollave, kopshteve të fëmijëve, qendrave të mjekësisë familjare dhe të ndërtesave kolektive. Nga 14,7ha të sipërfaqes së komunës, të gjitha kishin mirëmbajtje të rregullt. Po ashtu, komuna ka 37 hapësira publike dhe se të gjitha deklarohet të kenë ndriçim publik.

Fusha 9: Infrastruktura Lokale

Performanca e përgjithshme në këtë fushë ishte mjaft e ulët 37.8%, megjithatë ka patur disa tregues të rinj në këtë fushë. Komuna ka deklaruar se ka të shtrura me asfalt 643.7km rrugë nga gjithsej 771.7km rrugë në territorin e komunës ndërsa 44.2 nga këto kilometra të shtrura me asfalt janë shtruar në vitin raportues, 2019. Komuna deklaroi se 2.6% të rrugëve të komunës kanë patur mirëmbajtje verore, apo 19.8km, ndërsa 39.7% kanë patur mirëmbajtje dimërore, apo 306km.

Me trotuare dalin të jenë 18.6% e rrugëve në zona urbane dhe vendbanimeve me fshatra ndërsa me ndriçim publik 31.6% të të gjitha rrugëve. Me shenjëzim vertikal dhe horizontal kanë qenë 13.6% të rrugëve, apo 105 kilometra, ndërsa ka vetëm 3.7 kilometra rrugë me stazë të biçikletave në zona urbane. Për riasfaltim ishin vlerësuar 5.2 km rrugë për vitin 2019 dhe komuna ka arritur të riasfaltoj të gjitha kilometrat e planifikuar.

Fusha 10: Transporti Publik

Performanca e përgjithshme në këtë fushë del 64.9%. Komuna e Gjakovës deklaroi të ketë planifikuar 65 veprime për transport publik në planin vjetor të saj për këtë fushë dhe se të gjitha nga ato ishin realizuar në vitin raportues. Megjithatë, duhet protokolluar vendimet për mbulimin e vijave transportuese të vendbanimeve. Komuna deklaroi se 58 nga 91 vendbanimet e saj janë të përfshira në transport publik. Megjithatë, vetëm 58 nga 178 nga vendalimet për transport publik janë të shenjuara në mënyrë adekuate apo 32.6%.

Fusha 11: Parkingjet Publike

Performanca e përgjithshme në këtë fushë del 26.9%. Gjithsej në Komunën e Gjakovës janë 24 parkingje publike. Ndërsa janë deklaruar 1,128 vendparkime publike për 21,925 makina të regjistruara në komunë, pra shkallë 5.1%. Gjithsej janë 40 vendparkime publike të destinuara për taksit, që përbën 58.8% të numrit të taksive të licencuara nga komuna. Nga 24 parkingjet publike deklarohet se vetëm 4 prej tyre kanë hapësirë të rezervuar për vozitës me nevojë të veçanta.

Fusha 12: Ujë i Pijshëm

Performanca e përgjithshme në këtë fushë del 87.5%. Komuna deklaroi se ka patur 16 projekte për rrjetin e ujësjellësit dhe se janë realizuar 12 nga to gjatë vitit 2019. Ndërsa deklaroi se 100% të ekonomive familjare, institucioneve publike dhe bizneseve janë të kyçura në rrjet të ujësjellësit.

Fusha 13: Kanalizimi

Performanca e përgjithshme në këtë fushë del 43.7%. Komuna deklaroi se ka patur 2 projekte për rrjetin e kanalizimit dhe se që të dyja janë realizuar gjatë vitit 2019. Ndërsa deklaroi se 74.7% të ekonomive familjare, institucioneve publike dhe bizneseve janë të kyçura në rrjet të ujësjellësit. Megjithatë, gjatë verifikimit nuk ka dalë se ka vendbanime të kyçura në trajtim të ujërave të zeza, përmes impianteve.

Fusha 14: Menaxhimi për Mbeturina

Performanca e përgjithshme në këtë fushë del 88.0%. Komuna deklaroi se ka patur plan për menaxhimin e mbeturinave dhe se për vitin raportues janë planifikuar 4 aktivitete ndërsa dy nga ato të planifikuara janë realizuar. Deklarohet se 85.8% të ekonomive familjare, institucioneve publike dhe bizneseve janë të kyçura në sistemin për grumbullimin e mbeturinave. Po ashtu, komuna deklaroi se ka planifikuar 313 ditë të vitit të mbledh mbeturinat dhe se kjo është realizuar në masën 98.7%. Komuna deklaroi se inkasimi për pagesat e mbeturinave ishte realizuar në masën 93.8% ku janë mbledhur afër 1.1 milion euro nga gjithsej afër 1.2 milion euro të faturuara.

Komuna ka arrit në 100 % standardin për deponimin e mbeturinave për kokë banori. Vlerësimi bëhet kundër një mesatare standarde minimale të mbeturinave të deponuara në Bashkim Evropian (BE) që është 300kg mbeturina të deponuar për person në vit. Andaj deponimi i mbeturinave në këtë nivel për person në komunë konsiderohet vlerësim maksimal (100%).

Fusha 15: Mbrojtja e Ambientit

Performanca e përgjithshme në këtë fushë del 86.8%. Komuna deklaron se ka patur 78 veprime komunale mjedisore të parapara me Planin për Mjedisin dhe se 55 janë realizuar gjatë vitit raportues. Leje mjedisore të kërkuar del të jenë 30 për vitin 2019 ndërsa 27 nga këto leje mjedisore janë lëshuar, apo 90.0%. Nga lejet mjedisore të lëshuara për ndërtesat e reja, komuna deklaron se 100% të tyre janë inspektuar gjatë vitit dhe të gjitha janë zbatuar nga ndërtuesit. Përderisa ishte lëshuar një gjoba për mos posedim dhe zbatim të këtyre lejeve dhe një fletëparaqitje në gjykatë për mos posedimin dhe zbatimin e këtyre lejeve.

Fusha 16: Përfaqësimi Gjinator

Fusha për përfaqësimin gjinator me 11 tregues është shtuar për këtë vit në SMPK edhe pse tre tregues kanë qenë të më hershëm në fusha të ndryshme. Performanca e përgjithshme në këtë fushë del 48.9%. Nga 2,428 të punësuar në institucionet komunale, 1,217 dalin të jenë nga gjinia femërore. Ndërsa nga 146 pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive, 45 dalin të jenë nga gjinia femërore. Vetëm 2 nga 12 drejtoritë komunale udhëhiqen nga gjinia më pak e përfaqësuar, gratë. Ndërkaq, dy Komitetet e përhershme të Kuvendit, ai për Politikë dhe Financa dhe ai për Komunitete, deklarohet se kanë nga 44.5% dhe 55.5% anëtarë të gjinisë femërore, respektivisht. Kurse përqindja e grave në komitetet tjera del të jetë 60%.

Përfaqësimi i grave në udhëheqje të këshillave lokal është i ulët si në tërë Kosovën ku janë të themeluar këta këshilla. Në rastin e Gjakovës asnjë nga 30 këshillat lokal nuk udhëhiqen nga gra ndërsa janë 37 gra anëtare të këtyre këshillave.

Komuna e ka të përpiluar dhe publikuar buxhetin e përgjegjshëm gjinator për vitin 2019 dhe deklaron se ka përfshirje gjinore në raportet financiare periodike. Komuna deklaron se ka të miratuar planin komunal për barazi gjinator për 2019 si dhe ka përpiluar raport për realizimin e këtij plani. Pjesëmarrja e grave në takime publike del të jetë 9.7% apo 250 gra nga gjithsej 2587 pjesëmarrës në konsultime publike.

Buxheti i ndarë për skema të punësimit, dhe ndërmarrësisë për gra dhe vajza, subvencionet në bujqësi dhe zhvillim ekonomik deklarohen 27,067 euro nga 179,000 euro të përgjithshme për këto subvencione. Ndërsa 13 nga 103 e këtyre subvencioneve janë dedikuar për përfituese gra. Nga 212 rrugët e komunës të emëruar pas emrave të personave fizik, 61 deklarohet se janë të emëruar pas personave fizik të gjinisë femërore. Ndërsa, 14.9% të pronave në komunë deklarohet se janë të regjistruara në emër të dy personave me gjini të ndryshme.

Fusha 17. Arsimi Parauniversitar

Është kjo fushë e re, për herë të parë e zbatuar në raportimin e vitit 2019, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 20 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 59.9%. Çerdhe/kopshte në zona rural nuk ka në Komunë e Gjakovës dhe janë vetëm pesë çerdhe publike në zonën urbane. Prandaj edhe nuk ka fëmijë të zonave rurale që vijnë çerdhen/kopshtin. Ndërsa gjithsej 227 fëmijë të moshës 0-3 vijnë në kopshtin nga 3,290 fëmijë të kësaj moshe në gjithë komunën.

Kurse aspektet e infrastrukturës tregojnë performancë mesatare, pajisja me kabinet të internetit 43.5% apo 20 prej 46 shkollave, shkolla me masa të eficiencës së energjisë në nivel 37.0% apo 17 prej 46 shkollave, plotësimi me kushtet e kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucione shkollor në nivel 55% apo mesatarisht 26 prej 46 shkollave i plotësojnë kriteret infrastrukture dhe pajisjeve.

Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar ka shënuar performancë prej 87.0% duke raportuar se prej 46 shkollave, 31 janë të pajisura me rrethoja dhe kamera, si dhe 46 prej tyre kanë dorëzuar raportin obligativ përmbledhës 2 herë në vit, ndërsa edhe KKSJ-ja ka raportuar 2 herë para kuvendit komunal.

Sigurimi i personelit të mjaftueshëm mësimor është shtyllë e rëndësishme në sigurimin e cilësisë në arsim, ku 1055 mësimdhënës janë raportuar të jenë të pajisur me licencë prej 1206 në përgjithësi, duke shfaqur një rezultat prej 87.5%. Komuna e Gjakovës po ashtu ka përmbushur në 62.9% shkallën e raportit të synuar për 26 nxënës për 1 mësimdhënës. Komuna e Gjakovës ka planifikuar të punësoj me konkurs të rregulltë 46 mësimdhënës të rinj gjatë vitit 2019, dhe kështu ka arritur ta përmbush këtë plan 100%.

Kurse tek plotësimi i vendeve të lira me konkurs plotësues ishte planifikuar për 12 mësimdhënës dhe zbatim ishte i plotë. Po ashtu, janë hapur pesë pozita për drejtor e zëvendës-drejtor dhe të gjitha kanë respektuar procedurat ligjore sipas konkursit publik.

Rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e 9-ta në Komunë e Gjakovës është në 55.1% (17.3.4). Ndërsa, kalueshmëria e nxënësve në provim të maturës, në komunën e Gjakovës është e lartë, me 79.9. Shkalla e braktisjes ishte mjaft e ulët andaj edhe vlerësimi për këtë tregues është 99.6%. Kurse zbatimi i orarit mësimorë, përkatësisht shkalla e realizimit të orëve të planifikuara rezulton me performancë prej 95.7%.

Fusha 18. Kujdesi Primar Shëndetësor

Kjo është fushë e re, për herë të parë e zbatuar në raportimin e vitit 2019, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 7 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 62.1%, ku treguesi me performancë më të ulët ishte ai për shkallën e plotësimit të buxhetit të shëndetësisë me të hyra vetanake, 3.7%.

Objektet e KPS që ishin të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë tregojnë performancë më të mirë, pasi që kanë vlerësimin maksimal prej 100%.

Hapësira e kujdesit primar në dispozicion është 604m² për 10,000 banorë, ndërsa plotësimi me mjete, pajisje, dhe shërbime laboratorike ka shkallë të lartë të performancës, me 100%, pra të gjitha qendrat e mjekësisë familjare i përmbushin kriteret e kërkuara. Nivelin e pajtueshmërisë me raportin e synuar 1 ekip mjekësisë familjare për 2000 banorë Komuna e Gjakovës pothuajse e arrin në shkallë të plotë me rezultat prej 87.4%. Numri i përgjithshëm i vizitave ishte 53,382 dhe kjo në raport me numrin e banorëve 94,556 është shkallë mjaft e lartë, por treguesi mat raportin e vizitave të 10 qytetarëve në raport me numrin e banorëve, me ç'rast kemi vlerë të performancës 5.6%. Shkalla e përfshirjes së fëmijëve në program të imunizimit është e lartë, 95.3% pasi 6,812 fëmijë nga 7,149 fëmijë sa ishin në program të imunizimit.

Fusha 19. Zhvillimi Ekonomik Lokal

Kjo është fushë e re, për herë të parë e zbatuar në raportimin e vitit 2019, e përbërë prej 1 rezultati dhe 4 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 64.7% pasi plani për zhvillim ekonomik lokal është raportuar se nuk ka aktivitete andaj edhe nuk ka realizim, si rezultat performanca për këtë tregues del 0%. Komuna deklaron se ka përditësuar dhe publikuar listën e pronave publike për dhënie në shfrytëzim me qëllim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik. Komuna po ashtu ka azhurnuar listën e objekteve komunale në shkallën prej 20% sa është norma ligjore, me ç'rast ka shënuar performancë prej 100%. Niveli i inkasimit të tatimit në pronë ka regjistruar shkallë jo të kënaqshme të përmbushjes, siç është raportuar, duke ju referuar vlerave të raportuara të faturimit (883,644 euro) dhe inkasimit (156,3768 euro).

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	96.42
	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	100.00
	1.1.4	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	60.00
TRANSPARENCA KOMUNALE	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online	100.00
	2.1.2	Niveli i qasje në dokumente publike nga qytetarët	100.00
	2.1.3	Përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	100.00
	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqën zyrtare të komunës	100.00
	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqën zyrtare të komunës	100.00
	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	80.00
	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave	75.00
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	50.00
	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	91.20
	3.1.3	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	100.00
	3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal	100.00
	3.1.5	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	0.00
	3.1.6	Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit	29.45
	3.1.7	Intervenimet për mbledhje të mbeturinave nga raportimet e qytetarëve	0.00
	3.1.8	Intervenimet në shpërthimet në ujëra të zeza	0.00
	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	100.00
	3.2.2	Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	100.00
	3.2.3	Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak	0.00
	3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Asamblenë Komunale	100.00
	3.2.5	Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale	0.00
	3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	100.00
	3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	72.95
	3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve	82.55
	3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit	26.00

	3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	0.00
	3.4.2	Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre	100.00
	3.5.1	Zbatimi i skemës për shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil	100.00
	3.5.2	Vende të hapura të punës që janë procesuar përmes SIMBNj	100.00
	3.5.3	Kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore	0.00
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	4.12
	4.1.2	Të punësuar nga komunitetet jo-shumicë	55.44
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social	22.81
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	100.00
KULTURË, RINI DHE SPORT	5.1.1	Hapësira për aktivitete sportive për numër të banorëve	44.20
	5.2.1	Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal	100.00
	5.2.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në veprimtari për kulturë, rini dhe sport	61.34
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive	100.00
	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë	100.00
PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunës i mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme)	4.66
	7.2.1	Kërkesa të shqyrtura për leje të ndërtimit	79.47
	7.2.2	Ndërtesa të reja të inspektuara	100.00
	7.2.3	Objekte të reja me leje të ndërtimit	84.21
HAPËSIRAT PUBLIKE	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m2 për kokë banori	1.55
	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	100.00
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	100.00
INFRASTRUKTURA RRUGORE	9.1.1	Rrugët lokale të shtruara	84.09
	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	2.57
	9.1.3	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	39.72
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	18.56
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	31.61
	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	13.61
	9.2.4	Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	3.87
	9.2.5	Rrugët lokale të riasfaltuara	100.00

TRANSPORTI PUBLIK	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik	98.46
	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	63.74
	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	32.58
PARKINGJET PUBLIKE	11.1.1	Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike	24.00
	11.1.2	Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës	5.14
	11.1.3	Vendparkimet e destinuara për taksi	58.82
	11.1.4	Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar	16.67
UJË I PIJSHËM	12.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	75.00
	12.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm	100.00
KANALIZIMI	13.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	100.00
	13.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit	74.74
	13.2.1	Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujrave të zeza	0.00
MENAXHIMI I MBETURINAVE	14.1.1	Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	50.00
	14.1.2	Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	85.77
	14.2.1	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	98.72
	14.2.2	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	93.76
	14.3.1	Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori	100.00
MBROJTJA E AMBIENTIT	15.1.1	Realizimi i planit të veprimtimit lokal në mjedis	70.51
	15.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	90.00
	15.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	100.00
PERFAQESIMI GJINOR	16.1.1	Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale	100.00
	16.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive	61.64
	16.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	33.33
	16.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	100.00
	16.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	9.82
	16.2.1	Buxheti dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor	50.00
	16.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	28.54
	16.2.3	Pjesëmarrja e grave në takime publike	19.33
	16.2.4	Plani komunal për barazi gjinore	100.00

	16.3.1	Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve	57.55
	16.3.2	Regjistrimi I pronësisë në emër të dy gjinive	14.94
ARSIMI PARAUNIVERISTAR	17.1.1	Çerdhe dhe kopshte në zona rurale për 10000 banorë	0.00
	17.1.2	m2 të hapësirave për nxënës – urban dhe rural	37.20
	17.1.3	Shkollat e paisura me kabinet te TIK	43.48
	17.1.4	Shkollat me masa te eficiencës së energjisë	36.96
	17.1.5	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	86.96
	17.1.6	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, paisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	55.47
	17.2.1	Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licensuar	87.48
	17.2.2	Niveli i pajtueshmërisë me raportin nxënës për mësimdhënëës - urban dhe rural	62.91
	17.2.3	Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake	3.21
	17.2.4	Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt	100.00
	17.2.5	Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues	100.00
	17.2.6	Respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues të shkollave (drejtorëve dhe zv.drejtorëve)	100.00
	17.3.1	Fëmijët që vijnë kopshtin - rural dhe përgjithësi (ndarje sipas gjinisë)	0.00
	17.3.2	Shkalla bruto e regjistrimit ne kl.1	0.00
	17.3.3	Shkalla e qasjes – tranzicioni kl9- k10	0.00
	17.3.4	Rezultatet e testit të arritshmërisë për kl.9-ta	55.07
	17.3.5	Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë)	79.91
	17.3.6	Indeksi i barazisë gjinore (për të gjitha nivelet ISCED 0-3)	86.81
	17.3.7	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	99.61
	17.3.8	Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit	95.74
SHENDETESIA PRIMARE	18.1.1	m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë	47.21
	18.1.2	Objektet e KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike	100.00
	18.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë	87.43
	18.2.2	Përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake	3.74
	18.3.1	Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori	5.65
	18.3.2	Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit	95.29

	18.3.3	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe femijë	100.00
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL	19.1.1	Plani për zhvillim ekonomik lokal	0.00
	19.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	100.00
	19.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë	100.00
	19.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	56.51